



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 korrik 2016
Nr. ref.:RK965/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI144/15

Parashtrues

Ismet Shabanaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit për Ankesa të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC -II-12- 0084,
të 1 tetorit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ismet Shabanaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga z. Qerim Ferizi, avokat nga Deçani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji për Ankesa i DHPGJS-së), AC -II-12- 0084, të 1 tetorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Kolegjit për Ankesa të DHPGJS-së, AC-II-12-0084, të 1 tetorit 2015.
4. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 8 dhjetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi (gjyqtarë).
8. Më 18 shkurt 2016, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit në lidhje me regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë autorizim të qartë për përfaqësim në Gjykatë. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.
9. Më 20 maj 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës është nipi dhe trashëgimtari i pasurisë së trashëgimlënësit D. SH.
11. Më 19 qershor 2003, D. SH. e autorizoi parashtruesin e kërkesës që ta përfaqësojë atë në procedurën gjyqësore në rastin C. nr. 18/01 në Gjykatën Komunale në Deçan në lidhje me konfirmimin e pronësisë. Parashtruesi i kërkesës ishte i autorizuar që ta përfaqësojë D. SH. në organet gjyqësore dhe administrative në Kosovë.

12. D. SH. vdiq më 10 tetor 2003, dhe më 11 qershor 2007, Gjykata Komunale në Deçan në procedurën e trashëgimisë e shpalli parashtruesin e kërkesës trashëgimtar të pasurisë së D. SH.
13. Në ndërkohë pasuan procedurat gjyqësore dhe rigjykimet duke filluar nga viti 2005 deri në vitin 2010 në DHPGJS dhe në Gjykatën Komunale në Deçan në lidhje me padinë për konfirmimin e pronësisë, të parashtruar nga përfaqësuesi i të ndjerit D. SH., të ngastrave kadastrale nr. 894 dhe 895 në Zonën Kadastrale në Deçan. Palë të paditura ishin NSH "Ramiz Sadiku"- njësia në Deçan, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Komuna e Deçanit.
14. Më 2 shkurt 2010, Gjykata Komunale në Deçan me Aktgjykimin C. nr. 287/2008 e aprovoi padinë e D.SH. si të bazuar dhe vërtetoi që D.SH. është pronar i ngastrës kadastrale nr. 895 dhe detyroi NSH "Ramiz Sadiku"- njësinë në Deçan, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Komunën e Deçanit që të dorëzojnë pronën në fjalë për regjistrimin e kësaj prone në emrin e D.SH.
15. Më 6 prill 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme duke pretenduar shkelje të ligjit dhe vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
16. Parashtruesi si trashëgimtar i pasurisë së D.SH. dhe palë e interesuar gjithashtu parashtrroi ankesë në procedurën në Dhomën e Posaçme.
17. Më 29 maj 2015, Dhoma e Posaçme urdhëroi (Urdhri AC-II-12-0084) përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës që të dorëzojë: (i) autorizimin për përfaqësim në procedurën në Dhomën e Posaçme dhe (ii) vendimin për ndryshimin e mbiemrit.
18. Më 25 qershor 2015, zyra e regjistrimit të Dhomës së Posaçme pranoi autorizimin për përfaqësim për çështjen në fjalë, të dhënë nga parashtruesi i kërkesës për avokatin e tij, një parashtrësë nga regjistri zyrtar për ndryshimin e mbiemrit dhe certifikatën e vdekjes së D.SH., të 5 tetorit 2003.
19. Më 26 qershor 2015, Dhoma e Posaçme lëshoi një urdhër të ri, duke kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë autorizimin e dhënë nga paditësi D.SH. Dhoma e Posaçme deklaroi se autorizimi i dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës më 25 qershor 2015 nuk është dhënë nga paditësi dhe shtoi, se nëse parashtruesi i kërkesës nuk i dorëzon provat e kërkuara brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Dhoma e Posaçme do ta refuzojë ankesën si të papranueshme.
20. Në ndërkohë, parashtruesi i kërkesës dorëzoi autorizimin që i ishte dhënë atij nga D.SH. në lidhje me lëndën C. nr. 18/01, certifikatën e vdekjes së paditësit D.SH. dhe vendimin për trashëgimi.
21. Më 1 tetor 2015, Kolegji për Ankesa i DHPGJS-së me Aktvendimin AC-II-12-0084 konstatoi si në vijim:

"1) ankesa është e bazuar, 2) Anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Deçanit C. nr. 287/08 i datës 02.02.2010, 3) Padia hedhet poshtë si e pa

pranueshme, 4) Nuk caktohen shpenzimet gjyqësore në procedurën ankimore”.

22. Nëse Kolegji për Ankesa i DHPGJS-së ka mbajtur shqyrtim me gojë, në pjesën përkatëse të Aktvendimit thuhet:

“Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Shtojca), Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës”.

23. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për t’u dëgjuar, në pjesën përkatëse të vendimit, Kolegji i Ankesave i DHPGJS thekson:

“Në bazë të këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit nuk mund t’i pranojë asnjërin nga autorizimet si të rregullta, për shkak se padia e dorëzuar në DHPGJS nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë, mungon nënshkrimi i padisë nga paditësit dhe mungon autorizim i dhënë për avokatin i cili ka nënshkruar padinë. Plotësimi i padisë nuk është bërë edhe pas urdhrorit të lëshuar nga Kolegji i Apelit...vendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS për pranueshmërinë e padisë nuk ia mohojnë të drejtën e paditësit për të parashtruar kërkesë të re, në pajtim me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me ligj”.

24. Sa i përket vlefshmërisë së vendimit (C. nr. 287/08, të 2 shkurtit 2010) të Gjykatës Komunale në Deçan, në pjesën përkatëse të aktvendimit thuhet:

“Aktvendimi i ankimuar i Gjykatës Komunale, Deçan C. nr. 287/2008 nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet të priset. Padia e parashtruar para DHPGJS më 08/11/2005 është nënshkruar nga avokati Pashë Kuqi. Në shkresat e lëndës gjendet një Autorizimi i dhënë për të nga paditësi për Gjykatën Komunale Pejë për lëndën 845/95 i viti 1997. Pas urdhrorit të lëshuar nga Gjykata për parashtrimin e autorizimit të dhënë nga Paditësi, nipi i paditësit Ismet Ali Shabanaj parashtroi një autorizim për përfaqësim, i dhënë nga ai për lëndën C.nr. 18/01 për Gjykatën Komunale në Deçan ndërsa më 10 qershor 2015 ai parashtron edhe Aktvendimin mbi shqyrtimin e trashëgimisë si dhe certifikatën e vdekjes së paditësit. Nga certifikata e vdekjes rezulton se paditësi ka vdekur më 05/08/2003”.

25. Sa i përket vlefshmërisë së dokumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës, në pjesën përkatëse të Aktvendimit thuhet:

“Të dy autorizimet i dedikohen lëndëve tjera në gjykatat të ndryshme dhe nuk janë të vlefshëm para DHPGJS-së. Ndërsa autorizimi i dhënë nga paditësi për Ismet Ali Shabanaj është kopje dhe daton nga vitit 2003. Në këto rrethana të sqaruara Kolegji i Apelit vlerëson se nuk kishte një padi të rregullt të nënshkruar nga paditësi. Autorizimet e parashtruara nuk janë në pajtim me nenin 25 të Urdhresës Administrative nr. 2008/6 (UA) e as sipas Ligjit për DHPGJS-në nr.04/L-033. Sipas të cilit nen, “Origjinali i

çdo parashtrere duhet të nënshkruhet nga pala ose avokati i palës, nëse pala ka përfaqësues ligjor...”. Sipas nenit 28.2 i Urdhëresës Administrative (UA) 2008/6 dhe të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në nr. 04/L-033 (Shtojca) padia është e pranueshme vetëm nëse: Parashtrësat janë paraqitur në përputhje me kushtet nga neni 25 të kësaj Urdhërese Administrative, gjegjësisht Shtojcës. Neni 28.4 i UA 2008/6 parasheh se nëse paditësi nuk paraqet padinë e kompletuar apo të korrigjuar, e cila i përmbush kushtet e parapara në paragrafin më lart brenda periudhës kohore të caktuar në vendim, Paneli Gjyqësor e hedh poshtë padinë mbi baza të papranueshmërisë. Në bazë të këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit nuk mund t’i pranojë asnjërin nga autorizimet si të rregullta, për shkak se padia e dorëzuar në DHPGJS nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë, mungon nënshkrimi i padisë nga paditësit dhe mungon autorizim i dhënë për avokatin i cili ka nënshkruar padinë. Plotësimi i padisë nuk është bërë edhe pas urdhrit të lëshuar nga Kolegji i Apelit”.

Legjislacioni përkatës

Ligji nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 64

Procedurat e ankesës me gojë

Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrëhet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrëhet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.

URDHËRESA ADMINISTRATIVE NR. 2008/6

PËR NDRYSHIMIN DHE ZËVENDËSIMIN E URDHËRESËS ADMINISTRATIVE TË UNMIK-ut NR. 2006/17, ZBATIMIN E RREGULLORES NR. 2002/13 PËR THEMELIMIN E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT

Neni 25

Parashtrimi i lutjeve

Origjinali i çdo parashtrere duhet të nënshkruhet nga pala ose avokati i palës, nëse pala ka përfaqësues ligjor. Origjinali bashkë me të gjitha shtojcat e përmendura aty dorëzohen në Zyrën regjistrimit bashkë me katër kopje për Dhomën e Posaçme dhe nga një kopje për çdo palë në procedurë. Kopjet duhet të vërtetohen nga pala e cila i paraqet ato. Regjistërmbajtësi mund të refuzojë të pranojë parashtrësat të cilat nuk janë në pajtim me këtë nen.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai është trashëgimtar ligjor i pasurisë së D.SH. Parashtruesi ofron si dëshmi vendimin për trashëgimi të Gjykatës Komunale në Deçan, të 11 qershorit 2007.
28. Sa i përket vazhdimit të kësaj çështjeje civile, parashtruesi pretendon: *“Në mënyrë që të vazhdojë kjo procedurë kontestimore, Ismet (Ali) Shabanaj si pasardhës universal i pasurisë, ka autorizuar Qerim Ferizi një avokat në Deçan, për të ndërmarrë të gjitha masat procedurale që kanë të bëjnë me paditësin në rastin AC-II-12-0084. Dëshmi: Autorizimi i 18.06.2015, LRP nr. 1926/2015 i noterizuar”.*
29. Sa i përket vlefshmërisë së dokumenteve të parashtruara nga parashtruesi në Kolegjin për Ankesa të DHPGJS-së, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Pasi që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës në vendimin e kundërshtuar ka deklaruar se në lidhje me kërkesën e tij nuk ka autorizim nga paditësi që të paraqesë kërkesën, kjo mund të vërtetohet, sepse në shkresat e lëndës ekziston autorizimi i DHËNË nga D.SH. nipit të tij Ismet (Ali) Shabanaj, ku, ndër të tjera, thuhet se: i autorizuar në emrin tim dhe në llogarinë time mund të më përfaqësojë në lëndën nr. C. nr. 18/01 pranë Gjykatës Komunale në Deçan për konfirmimin e pronësisë deri sa kjo çështje të finalizohet. I autorizuari gjithashtu mund të përfaqësojë paditësin edhe pas vdekjes eventuale (post mortum)”.*
30. Sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Bazuar në praktikën gjyqësore personi i autorizuar nga ana e paditësve duhet të ishte thirrur në seancën dëgjimore me gojë në atë gjykatë më 22 shtator 2015, në mënyrë që të paraqesë argumente dhe dëshmi gjatë seancës, sepse pa qenë i pranishëm në seancë, i njëjti nuk ka mundur të ushtrojë të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kështu që më pas është nxjerrë Aktvendimi C-III-13-0482 në dëm të paditësve”.*
31. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të konstatojë si në vijim:
“TË APROVOJË kërkesën për mbrojtjen e kushtetutshmërisë, të parashtruar nga i autorizuari Ismet (Ali) Shabanaj nga Deçani, ashtu që të ANULOHET Aktvendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë AC-II-12-0084, i 01.10.2015, dhe
TË VËRTETOJË Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan, C. nr. 287/2008 të 02.02.2010.”

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
34. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*
35. Më tej, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës i cili parasheh:
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
- ...
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
36. Gjykata vëren se në rastin në fjalë, thelbi i kërkesës së parashtruesit ka të bëjë me vlerësimin e gabuar nga ana e Kolegjit për Ankesa të DHPGJS-së të dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi, të cilat tregojnë se ai është pasardhësi ligjor dhe trashëgimtar i D.SH., dhe se, e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është shkelur për shkak se përfaqësuesi i tij nuk ishte ftuar në seancë dëgjimore me gojë të mbajtur në Kolegjin për Ankesa të DHPGJS-së.
37. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata vëren se Kolegji i Ankesave të DHPGJS-së, në pajtim me ligjin e aplikueshëm, vendosi që mos ta mbajë pjesën gojore të procedurës. Për më tepër në këtë çështje, Gjykata vëren se Kolegji i Ankesave të DHPGJS-së e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për shkaqe procedurale, duke deklaruar se parashtruesi nuk pengohet të paraqesë një kërkesë të re, në pajtim me kriteret e pranueshmërisë.
38. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit që kanë të bëjnë me vlefshmërinë e dokumenteve të sjella prej tij në Kolegjin për Ankesa të DHPGJS-së, Gjykata vëren se Kolegji për Ankesa i DHPGJS-së urdhëroi parashtruesin e kërkesës që të plotësojë padinë e tij në pajtim me kërkesat ligjore të cilat ky i fundit nuk arriti t'i përmbushë. Për më tepër në këtë pikë, Gjykata vëren se Kolegji për Ankesa i DHPGJS-së ka sqaruar se dokumentacioni i dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës ishte në lidhje me rastet e tjera dhe gjykatat e tjera, dhe

për këtë arsye, nuk vlen për procedurat në DHPGJS, përveç që ato ishin kopje të tyre dhe jo origjinali siç kërkohet me ligj.

39. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk mund të pretendojë se ai nuk kishte dobi nga procedurat kundërshtuese apo që nuk ka paraqitur argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte të rëndësishme për rastin e tij. Në këtë drejtim, Gjykata, në pajtim me parimin e subsidiaritetit nuk mund të zëvendësojë vendimin e vet me atë të Kolegjit për Ankesa të DHPGJS-së dhe të bëjë një vlerësim të ri të çështjeve të faktit dhe të ligjit tashmë të gjykuara nga Kolegji për Ankesa i DHPGJS-së.
40. Duhet të merret parasysh, sepse ky është burimi i shumë keqkuptimeve nga ana e parashtruesve të kërkesës, që “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 nuk është drejtësi “substanciale” (nacion që ndodhet në kufijtë e së drejtës dhe të etikës dhe që vetëm gjyqtari i faktit mund ta zbatojë), por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik kjo shprehet me procedurë kundërshtuese ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës (Shih rastin *Star Cate -Epilekta Gevmata dhe të tjerë kundër Greqisë*, kërkesa nr. 54111/07, GJEDNJ, Vendim i 6 korrikut 2010).
41. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës vetëm citon dispozitat e Kushtetutës, pa dëshmuar se si këto norma kushtetuese janë shkelur në dëm të tij siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
42. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).
43. Në të vërtetë, është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
44. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
45. Fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentuar për shkelje të neneve 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës (Shih, për shembull, rasti nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 majit 2012, paragrafi 28).

46. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet për shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Faktet e rastit nuk tregojnë që Kolegji për Ankesa i DHPGJS-së ka vepruar në kundërshtim me masat mbrojtëse procedurale të përcaktuara me Kushtetutë.
47. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe të specifikuar më tej me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 20 maj 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović




Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
